



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	03-03/DPK	Nr. Prot.	01-1947/16
Dep.		Bi. Prot.	
		Prot. No.	
Nr. ffaq.		Data:	
Broj. transkripc.	03	Datum:	01.06.2016
Nr. pages:		Data:	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	01/06/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/1354/16
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ Zyra e Prokurimit – K.K Prizren
CC:	z. Ramadan MUJA Kryetar Komune – K.K Prizren
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit në Prizren”

I nderuar z. OSMANKAJ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit në Prizren” me numër prokurimi: 622/16/049/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit në Prizren” me numër prokurimi: 622/16/049/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna Prizren keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit në Prizren” me numër prokurimi: 622/16/049/511, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 23/03/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për punë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë rast si rast për trajtim dhe në përputhje me misionin e saj ka konstatuar që duhet të jetë pjesë e monitorimit në këtë aktivitet prokurimi. Në saje të sajë Agjencia ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe ka njoftuar Autoritetin Kontraktues se Agjencia do të jetë pjesëmarrëse në monitorim gjatë punës së komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues e ka njoftuar Agjencinë për kohën dhe vendin e vlerësimit të ofertave dhe me këtë rast Agjencia Kundër Korrupsion ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit. Pas monitorimit të procesit të vlerësimit më datë 12/05/2016,13/05/2016 dhe 18-05/2016. Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se në Dosjen e Tenderit është paraqitur një mospërputhje mes numrave dhe përshkrimit me fjalë për referencat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Në ‘Njoftim për Kontratë’ dhe në “Doja e Tenderit”, tek III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, pika 5, është kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses Punët e natyrës të kësaj kontrate gjatë tre viteve të fundit (2012-2013-2014) Vlera e përgjithshme e punëve të natyrës së kontratës nuk duhet të jetë më pak se 4.000.000,00 €, deri sa tek Dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista me të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara të natyrës së kontratës në tri vitet e fundit duke ia bashkuar kontratat me shumat e tyre si dhe referencat përkatëse. Pra, me shifra janë kërkuar vitet 2012,2013 dhe 2014, ndërsa tre vitet e fundit nënkuptohet që janë 2013,2014,2015. Kjo mospërputhje ka sjellë në vështirësi të mëdha komisionin vlerësues gjatë procesit të vlerësimit dhe ka qenë e pamundur të definohet saktë se cilat vite mund të merren për bazë. Tek shumica e operatorëve ekonomik që kanë ofertuar, si pikë më e ndjeshme ka qenë çështja e referencave dhe në lidhje me këtë Agjencia ka konstatuar se tek operatorët ekonomik formulimi i devijuar nga autoriteti kontraktues ka krijuar konfuzion.*

Në lidhje me këtë, autoriteti kontraktues më datë 19/05/2016 i është drejtuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me pyetjen konkrete se si të veprohet tutje me këtë mospërputhje. Më datë 23/05/2016 komisioni i është përgjigjur autoritetit kontraktues me përgjigje të referuar nga ligji i prokurimit, përgjigje e cila nuk ka mund ta zgjidhë problemin e komisionit vlerësues për të vazhduar tutje me procesin. Si pasojë e sajë, komisioni vlerësues ka rekomanduar anulimin, në pamundësi për të vlerësuar drejtë ofertat.

Agjencia konstaton se një procedurë e tillë është e pamundur të finalizohet dhe kërkon nga autoriteti kontraktues që nëse e njëjta mund të procedohet sërish, të kihet parasysh të definoj mirë kërkesat dhe kriteret duke precizuar qartë edhe natyrën e punëve të njëjta.



Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

AGJENCIA
KUNDËR
KORRUPSION